**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**
**TIRANË**

**Nr.12473 Akti** **Dt.03.11.2021**
**Dt.regj.25.05.2021**

# V E N D I M

## " PËR SIGURIMIN E PADISË "

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga :

**GYQTARE : FATIME DEÇOLLI**

Sot më datë **03.11.2021** mori në shqyrtim në seancë përgatitore, kërkesën që i përket:

**PADITESE:** **Sanije Mehmeti**,me dtl.25.06.1965,banuese ne Tirane ne adresen rr.Donika Kastrioti,pll.14.
**Irena Mehmeti**,me dtl.04.09.1959.
Paditeset te perfaqesuara me prokure te posacme me nr.2513 rep dhe nr. 762 kol dt.07.05.2021 nga av.Nelda Lusha me nr.8670 license Dhoma e Avokatise Tirane.

**I PADITUR:** **Feti Mehmeti**,me dtl.14.01.1950,banues ne Tirane ne adresen rr.Hafiz Ibrahim Dalliu nr.68/1. Perfaqesuar me prokure te posacme me nr.1359 rep dhe nr. 308 kol dt.21.09.2021 nga av.Alban Avdulla me nr.10590 license Dhoma e Avokatise Tirane.

**Person i trete:** **Eqerem Mehmeti**,me dtl.14.05.1959,banues ne Tirane ne adresen rr.Donika Kastrioti,pll.14. (ne mungese)
**Halim Mehmeti**,me dtl.13.04.1955,banues ne Tirane ne adresen njesia administrative nr.9. (ne mungese)

**OBJEKTI:** Konstatimin e pavlefshmërisë absolute së Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.1096 Rep., Nr.155 Kol., datë 14.04.2008, Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.2531 Rep., Nr.388 Kol., datë 28.09.2010 dhe Kontratës së Dhurirnit të Kuotave të Kapitalit, datë 04.02.2020, si veprime juridike të kryera në kundërshtim me ligjin.
Detyrimin e të padituri të njohë paditësen Sanije Mehmeti pronare mbi 11.9% të kapitalit dhe paditësen Irena Mehmeti mbi 1.1 % të kapitalit të shoqërisë Ble-Klo-Ar shpk, për shkak të pavlefshmërisë absolute të Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.1096 Rep., Nr.155 Kol., datë 14.04.2008, Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.2531

Rep., Nr.388 Kol., datë 28.09.2010 dhe Kontratës së Dhurimit të Kuotave të Kapitalit, datë 04.02.2020.
Detyrimin e të padituri tu kthejnë paditëseve çdo përfitim që ka marrë nga "cilësia e ortakut respektivisht mbi 11.9 % pjesë të kapitalit të "përfituar nga Eqerem Mehmeti dhe 1.1 % pjesë të kapitalit të përfituar nga Halim Mehmeti, deri në ditën e marrjes formë të prerë të vendimit gjykatës.
Detyrimin e të padituri tu kthejnë paditëseve çdo përfitim që ka marrë nga "cilësia e ortakut respektivisht mbi 11.9 % pjesë të kapitalit të "përfituar nga Eqerem Mehmeti dhe 1.1 % pjesë të kapitalit të përfituar nga Halim Mehmeti, deri në ditën e marrjes formë të prerë të vendimit gjykatës.
Urdhërimin e QKB të reflektojë në Regjistrin Tregtar dhe në ekstraktin e QKB pasojat e pavlefshmërisë së Kontratës së Shitblerjes së Kuotes Nr.l096 Rep., Nr.155 Kol., datë 14.04.2008, Kontratës së Shitblerjes së Kuotes Nr.2531 Rep., Nr.388 Kol., datë 28.09.2010 dhe Kontratës së Dhurimit të Kuotave të Kapitalit, datë 04.02.2020.
Marrja e masës së sigurimit të padisë nëpërmjet pezullimit të ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i kuotës (e drejta e votës, e drejta fitimit të dividentit) si edhe ndalimin e tjetërsimit të kuotave të zotëruara në shoqërinë Ble-Klo-Ar shpk nga i padituri Feti Mehmeti deri në marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 92,199 e vijues,208 te K.Civil,nenet 202 e vijues,154 e vijues te K.Pr.Civile,K.Familjes,ligji nr.9901 dt.14.04.2008.

Gjykata pasi degjoi palen paditese,e cila kërkoi marrjen në shqyrtim të kërkeses per sigurimin e padisë;

Pasi degjoi palen e paditur,e cila kerkoi rrezimin e kerkeses per sigurimin e padisë;

Në mungese te personave te trete ;

Shqyrtoi provat shkresore të depozituara nga palët prezent deri në këtë fazë të hetimit gjyqësor ;

**VËREN:**

Paditësja Sanije Mehmeti ka lidhur martesë ligjore me z.Eqerem Mehmeti më datë21.11.1989, ndërsa Paditësja Irena Mehmeti ka lidhur martesë ligjore me z.Halim Mehmeti më datë 12.08.1980

Gjatë kohëzgjatjes së martesave të tyrë, këta të fundit së bashku me Feti Mehmeti, kanë themeluar shoqërinë Ble-Klo-Ar shpk, NIPT J62904379V, datë 05.03.1997, tek e cila zotëronin fillimisht kuotat si vijon: Eqerem Mehmeti (40%), Halim Mehmeti (10%) dhe Feti Mehmeti (50%).

Gjatë aktivitetit të Shoqërisë, bashkëshortët e Paditëseve, kanë kryer disa tjetërsime të pjesës së zotëruar në kapitalin e Shoqërisë, të gjitha këto pa marrë më parë pëlqimin e bashkëshorteve të tyre, Paditëseve. Konkretisht:Me anë të Kontratës së Shitblerjes së Kuotës

Nr.1096 Rep., Nr.155 Kol., datë 14.04.2008, Eqerem Mehmeti ka disponuar dhe tjetërsuar në favor të të paditurit Feti Mehmeti 2% të kuotës së tij në Shoqëri.

Më tej, me anë të Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.2531 Rep., Nr.388 Kol., datë 28.09.2010, Eqerem Mehmeti ka disponuar dhe tjetërsuar në favor të të paditurit Feti Mehmeti 9.35% të kuotës së tij në Shoqëri, ndërsa Halim Mehmeti ka disponuar dhe tjetërsuar në favor të të paditurit Feti Mehmeti 1.1% të kuotës së tij në Shoqëri.

Në vijim, me anë të Kontratës së Dhurimit të Kuotave të Kapitalit, datë 04.02.2020, Eqerem Mehmeti ka disponuar dhe tjetërsuar në favor të të paditurit Feti Mehmeti 0.55% të kuotës së tij në Shoqëri.

Në total, Feti Mehmeti ka përfituar 11.9% të kapitalit të Shoqërisë, nga Eqerem Mehmeti dhe 1.1% nga Halim Mehmeti, pa pëlqimin e bashkëshorteve respective.

Paditësja i është drejtuar gjykatës me padinë në gjykim, duke pretenduar se ekzistojnë rrethana dhe elemente sunstancialë që në fakt venë në dyshim ligjshmërinë e këtij veprimi juridik.

***Konkretisht paditëset kanë pretenduar deri në këtë fazë të shqyrtimit gjyqësor se:***

Paditëset kanë qenë të martuara nën regjimin e bashkësisë ligjore, në kohën kur janë kryer veprimet e tjetërsimit të pasurisë së përbashkët - "kuotat"në Shoqëri.

Sipas Kodit të Familjes, në zbatim të nenit 74/a, bën pjesë nën bashkësinë ligjore, pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës duke përfshirë këtu edhe çdo veprimtari tregtare. Përjashtohen nga bashkësia vetëm sendet vetjake, sipas përcaktimit të nenit 77 të Kodit të Familjes.

Sipas nenit 74/c në bashkësinë ligjore përfshihet edhe aktiviteti tregtar i krijuar gjatë martesës. Kjo do të thotë se aktiviteti tregtar do të konsiderohet i përbashkët dhe për më tepër kuotat e zotëruara nga njëri bashkëshort në një shoqëri tregtare janë pasuri si çdo pasuri tjetër në kuptimin e së drejtës civile, që përfshihet në regjimin e bashkësisë ligjore pavarësisht nëse formalisht zotëruesi kuotës është njëri apo të dy bashkëshortët. Kjo lloj pasurie quhet nga ligji si në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve dhe për këtë shkak kërkohet që për çdo veprim disponimi të kuotës që do të kryejë njëri bashkëshort,duhet që të shprehë vullnetin edhe bashkëshorti tjetër.

Nëse një veprim disponimi I kuotës kryhet pa shprehur lirisht pëlqimin edhe bashkëshorti tjetër, ky veprim disponimi është nul pasi kryhet në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit në kuptim të nenit 92/a të Kodit Civil dhe të nenit 208 të këtij Kodi. Meqenëse edhe veprimtaria tregtare përfshihet në pasurinë e përbashkët, duhet që sipas nenit 208 të K.Civil të japin pëlqimin të dy bashkëshortët në përputhje edhe me nenin 90 të Kodit të Familjes. Neni 90 i K.Familjes është një dispozitë urdhëruese e ligjit dhe mosrespektimi i saj sjell pavlefshmëri absolute të veprimit të disponimit të pasurisë.

Kështu tjetërsimi në total i 13% të kapitalit të zotëruar në bashkëpronësi nga Paditëset së bashku me bashkëshortët e tyre (në mënyrë të mëvetshme 11.9% dhe 1.1% secili) në Shoqërinë Ble-Klo-Ar shpk, është kryer pa pëlqimin e Paditëseve, si bashkëpronare në prezumimin e ½ pjesë së bashkëpronësisë në tërësi mbi kuotën e zotëruar nga bashkëshortët respektive të tyre, Eqerem Mehmeti dhe Halim Mehmeti. Për këtë shkak dhe për gjithë sa u tha më lart, ky veprim disponimi është nul dhe nuk ka prodhuar asnjë pasojë ligjoredhe për këtë shkak konsiderohet sikur nuk është kryer ndonjëherë dhe në përputhje me të drejtat e palëve konsiderohet se nuk kanë ndryshuar ndonjëherë statusin juridik. Kjo do të thotë se

kalimi i pjesës së kapitalit nga Eqerem Mehmeti dhe Halim Mehmeti tek i padituriFeti Mehmeti, nuk është kryer asnjëherë.

Për sa më sipër konkludojmë se kontratat e tjetërsimit të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë Ble-Klo-Ar shpk, Kontratë e Shitblerjes së Kuotës Nr.1096 Rep., Nr.155 Kol., datë 14.04.2008, Kontratë e Shitblerjes së Kuotës Nr.2531 Rep., Nr.388 Kol., datë 28.09.2010 dhe Kontratë e Dhurimit të Kuotave të Kapitalit, datë 04.02.2020, përbëjnë veprime juridike absolutisht të pavlefshme, pasi mungon në këto kontrata nënshkrimi dhe për pasojë pëlqimi i bashkëshorteve, si bashkëpronare prej ½ pjesë në kuotën e disponuar prej bashkëshortëve të tyre respektivisht. Për këtë shkak, këto veprime tjetërsimi të kuotës, janë kryer në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, konkretisht dispozitave të Kodit të Familjes, cituar më sipër.

***Ne lidhje me marrjen e masës së sigurimit të padisë, paditëset kanë pretenduar se:***

I padituri figuron aktualisht zotërues i kuotës që përfaqëson 43% të kapitalit të Shoqërisë. Që prej 2020, përmes një kontrate dhurimi të nënshkruar nga Feti Mehmeti në cilësinë e shitësit dhe Bledar Mehmeti, djali i tij në cilësinë e blerësit, ky i fundit është bërë pronar i kuotës që përfaqëson 20% të kapitalit të Shoqërisë. Kështu, të dy së bashku janë zotërues të 63 % të kapitalit të Shoqërisë, pra kuorumin e nevojshëm për të marrë jo vetëm vendimet e zakonshme, por edhe vendime ekstreme në lidhje me Shoqërinë por edhe ndaj ortakëve në minorancë sikurse janë, ndarja e dividentit, prishja e shoqërisë, tjetërsimi i kuotave tek të tretë apo kryerja e veprimeve për të mbingarkuar shoqërinë me borxhe.

Nëse i padituri, i asistuar edhe nga djali i tij Bledar Mehmeti, njëkohësisht administrator i Shoqërisë, do të ushtronte të drejtat e sipërpërmendura, për shkak të zotërimit së bashku të 63% të kapitalit të Shoqërisë, kjo gjë do të thellonte më tej veprimtarinë dhe ecurinë tregtare të Shoqërisë dhe më tej realizimin e të drejtave të kërkuara me padi, për të dy Paditëset.

Kështu për shembull në rast të transferimit të pronësisë së kuotës tek të tretët, shqyrtimi i mëtejshëm i padisë për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik dhe rregullimi i pasojave të tij, nuk do të ketë më kuptim dhe Paditëset do të humbasin të gjitha mundësitë për rikuperimin e dëmeve të pësuara.

Më tej, ushtrimi i të gjitha të drejtave të rrjedhura nga zotërimi i kuotës nga i padituri, e bën të pakuptimtë proçesin që Paditëset kanë filluar kundër tij dhe në gjykim do duhet të thërriten eventualisht palë të tjera ndërgjyqëse.

Po kështu, ushtrimi i të gjitha të drejtave të rrjedhura nga zotërimi i kuotës nga i padituri, do të bënte të pamundur zbatimin e vendimit të ardhshëm të gjykatës, cilido qoftë ai. Vendimi i gjykatës do të mbetej i paekzekutuar pasi çdo lloj vendimi që do jepej nuk do mund ta ndryshonte situatën që rezultonte nga tjetërsimi i kuotës tek të tretët gjatë kohës së zhvillimit të proçesit do të sillte pasoja të rënda dhe do të vendoste Paditëset në një situatë të vështirë edhe në rast suksesi në gjykim.

Përsa parashtruam më sipër, i kërkojmë Gjykatës të vendosë masën e sigurimit të padisë sipas objektit të saj, deri në përfundim të këtij procesi gjyqësor.

**I padituri Feti Mehmeti**, nëpërmjet përfaqsuesve të tij në gjykim ka kërkuar rrëzimin e kërkeses për sigurimin e padisë ( më hollësisht arsyet e parashtruara nga perfaqsuesit në séancen audio të datës 29.10.2021 të parashtruar verbalisht )

**Po kështu nga gjykata është patur parasysh parashikimi ligjor mbi të cilën ka bazuar kërkesën e tij paditësi:**

**Neni 202**

*(Shtuar fjalë në paragrafin e parë me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 10)*

Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Sigurimi i padisë lejohet kur:

a) padia mbështetet në prova me shkresë;

b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja "a" e këtij neni.

**Neni 203**

*(Shtuar paragrafi i dytë, me ligjin nr. 122/2013)*

Sigurimi i padisë lejohet për të gjitha llojet e padive dhe në çdo fazë të gjykimit, derisa vendimi të marrë formë të prerë. Sigurimi i padisë lejohet edhe nga gjykata e apelit, kur padia është duke u shqyrtuar prej saj.

Sigurimi i padisë nuk lejohet në rastet e padive që ngrihen gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit, për të cilat zbatohet pjesa e katërt e këtij Kodi.

**Neni 206**

**Llojet e masave për sigurimin e padisë**

*(Ndryshuar shkronja "b" e paragrafit të parë, me ligjin nr. 122/2013)*

Sigurimi i padisë bëhet:

a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit;

b) me anë të masave të tjera të përshtatshme të marra nga gjykata.

Gjykata mund të lejojë sigurimin e padisë me disa nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, por gjithmonë për një shumë të përgjithshme jo më të madhe se atë të padisë.

Sekuestër nuk mund të vihet mbi sende që, sipas nenit 529 të këtij Kodi, nuk mund të sekuestrohen.

**ARSYETIMI LIGJOR I GJYKATËS**:

Referuar neneve 202 e vijues të K.Pr.Civile, gjykata çmon se në këtë fazë të shqyrtimit gjyqësor, për marrjen e masës së sigurimit të padisë, duhet të vërtetohen dy kushte:

***a)****Ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjykimit të padisë;*

***b)****Ekzistenca e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të beje te pamundur ose te vështirë mbrojtjen e te drejtes.*

Po kështu kjo gjykate iu referua dhe pati parasysh edhe Vendimin Unifikues te Gjykatës së Lartë nr.10, dt.24.03.2004, I cili konkludon se: "**nëpërmjet marrjes së masës së sigurimit të padisë gjykata synon "të mbajë gjendjen ashtu siç është", apo "te ngrire" deri ne zgjidhjen perfundimtare te konfliktit, e cili per vete natyren e ceshtjes, duhet te realizohet nepremjet nje procedure te shpejte dhe relativisht te thjeshtë. Nepermjet marrjes se mases se sigurimit te padise jo vetem sigurohet e drejta e pretenduar, e cila përbën dhe teresin dhe thelbin e kerkimit, por ne te njeten kohe marrja e kesaj mase siguron efektivitetin dhe dobishmerine e procesit gjyqesor".**

Sipas këtyre parashikimeve proceduriale, nëpërmjet masës së sigurimit të padisë vendimi i ardhshëm i Gjykatës do të mund të gjejë zbatim. Ndaj dhe masat e sigurimit të padisë, shihen si mjete që garantojnë ekzekutueshmërinë e një vendimi dhe rrjedhimisht të rivendosjes së një të drejte, të pretenduar nga paditësi me padi.

Në rastin object gjykimi, paditëset I janë drejtuar gjykatës midis të tjerave edhe për marrjen e masës së sigurimit të padisë me këto kërkime:

Marrja e masës së sigurimit të padisë nëpërmjet:

1.pezullimit të ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i kuotës (e drejta e votës, e drejta fitimit të dividentit);

si edhe:

2. ndalimin e tjetërsimit të kuotave të zotëruara në shoqërinë Ble-Klo-Ar shpk nga i padituri Feti Mehmeti deri në marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës.

Kjo kërkesë e paditëseve është në kuadër të kërkimeve në padinë me object:

*1.Konstatimin e pavlefshmërisë absolute së Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.1096 Rep., Nr.155 Kol., datë 14.04.2008, Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.2531 Rep., Nr.388 Kol., datë 28.09.2010 dhe Kontratës së Dhurimit të Kuotave të Kapitalit, datë 04.02.2020, si veprime juridike të kryera në kundërshtim me ligjin. 2.Detyrimin e të padituri të njohë paditësen Sanije Mehmeti pronare mbi 11.9% të kapitalit dhe paditësen Irena Mehmeti mbi 1.1% të kapitalit të shoqërisë Ble-Klo-Ar shpk, për shkak të pavlefshmërisë absolute të Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.1096 Rep., Nr.155 Kol., datë 14.04.2008, Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.2531 Rep., Nr.388 Kol., datë 28.09.2010 dhe Kontratës së Dhurimit të Kuotave të Kapitalit, datë 04.02.2020. 3. Detyrimin e të padituri tu kthejnë paditëseve çdo përfitim që ka marrë nga "cilësia e ortakut", respektivisht mbi 11.9 % pjesë të kapitalit të përfituar nga Eqerem Mehmeti dhe 1.1% pjesë të kapitalit të përfituar nga Halim Mehmeti, deri në ditën e marrjes formë të prerë të vendimit gjykatës.*

Gjatë gjykimit te kesaj çështjeje deri në këtë fazë të shqyrtimit gjyqësor, nëpërmjet provave shkresore të paraqitura nga pala paditëse, u provua :

**-Ekzistenca e të drejtës së pretenduar** që lidhet drejtëpërdrejtë me ekzistencën e Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.1096 Rep., Nr.155 Kol., datë 14.04.2008, Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.2531 Rep., Nr.388 Kol., datë 28.09.2010 dhe Kontratës së Dhurimit të Kuotave të Kapitalit, datë 04.02.2020, object gjykimi per verifikim të ligjshmerisë, pretendimi I parashtruar nga paditësja në padi.

Pretendimi I paditëseve lidhet me faktin që këto kontrata të paligjshme kanë prodhuar një situatë të padëshiruar nga paditëset si bashkepronare prej ½ pjesë në kuotën e disponuar prej bashkëshortëve të tyre, respektivisht Eqerem dhe Halim Mehmeti, duke I mohuar për rrjedhim, të drejtën e pronësisë mbi këto kuota.

**-<u>Ekzistenca e frikës për pamundësinë e realizimit të të drejtës nëpërmjet gjykatës.</u>** pasi me tjetersimin e pjesës takuese të pasurise object gjykimi, paditeset nuk kanë mundesi te rivendosin te drejten e pretenduar nepermjet ketij procesi gjyqësor.

Gjykata çmon se në kushtet e rrethanat në të cilat vertetohet se rezulton marëdhenia mes palëve të këtij procesi, konkretisht ekzistenca e Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.1096 Rep., Nr.155 Kol., datë 14.04.2008, Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.2531 Rep., Nr.388 Kol., datë 28.09.2010 dhe Kontratës së Dhurimit të Kuotave të Kapitalit, datë

04.02.2020, del e nevojshme marrja e një mase për sigurimin e padisë, sikurse është edhe ajo e kerkuar nga paditëset në padi:

***"ndalimin për tjetërsimin e kuotave të zotëruara në shoqërinë Ble-Klo-Ar shpk nga i padituri Feti Mehmeti deri në marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës"***, si një prej masave të sigurimit të parashikuara nga neni 206 i K.Pr.Civile.

Gjykata çmon se kjo masë garanton padinë, brenda kufijve të kërkimit të saj, saktësisht brenda kufijve të kërkimit për : *Detyrimin e të padituritë njohë paditësen Sanije Mehmeti pronare mbi 11.9% të kapitalit dhe paditësen Irena Mehmeti mbi 1.1% të kapitalit të shoqërisë Ble-Klo-Ar shpk, për shkak të pavlefshmërisë absolute të Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.1096 Rep., Nr.155 Kol., datë 14.04.2008, Kontratës së Shitblerjes së Kuotës Nr.2531 Rep., Nr.388 Kol., datë 28.09.2010 dhe Kontratës së Dhurimit të Kuotave të Kapitalit, datë 04.02.2020* (kërkimi nr.2 në padi).

Nga ana tjeter, gjykata çmon se kërkimi tjetër për sigurimin e padisë : "*pezullimi I ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i kuotës (e drejta e votës, e drejta fitimit të dividentit),* është një kërkim I cili tejkalon objektin e gjykimit si dhe I kundrejtohet një personi të tretë jo palë e gjykimit, shoqerisë Ble-Klo-Ar Shpk. Një kërkesë e tillë, qartazi ndikon drejteperdrejte veprimtarine e kësaj shoqerie nëse do të merej si masë garantore sipas kerkeses së paditëseve.

Së pari, gjykata çmon se ky kërkim bie ndesh me parimin e kontradiktorialitetit në gjykim: **"askush nuk mund të gjykohet pa u degjuar ose pa u thirrur në gjykim"** (neni 18 I K.Pr.Civile) ;

Së dyti, kerkimi nuk ka lidhje me objektin e gjykimit, pra me padinë.

Perfundimisht, gjykata cmon se kerkesa e paditeses per marrjen e mases se sigurimit të padisë, nepermjet caktimit të njërës prej masave të sigurimit te parashikuara në nenin 206 të K.Pr.Civile, sipas kerkimit te paditëses,duhet te pranohet, me qellimin e vetem garantimin e zgjidhjes se te drejtes se pretenduar nepermjet nje procesi gjyqesor.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 202 etj të K.Pr.Civile;

## V E N D O S I

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës së palës paditëse Sanije Mehmeti dhe Irena Mehmeti.
2. Marrjen e masës së sigurimit të padisë nëpërmjet ndalimit të tjetërsimit të kuotave të zotëruara në shoqërinë Ble-Klo-Ar shpk nga i padituri Feti Mehmeti në masën deri në 13%, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës.
3. Rrëzimin për pjesën tjetër të kërkimit.
4. Kundër vendimit që ka lejuar marrjen e masë së sigurimit (pika 2) lejohet ankim i veçantë ne Gjykatën e Apelit Tiranë.

**Tiranë, më dt.03.11.2021.**

**G J Y Q T A R E**
**FATIME DEÇOLLI**